# DËSHMI ARKIVI

**A-468431**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Radio dhe kitarë elektrike pa pushim, policia arreston 61-vjeçarin pas 7 vitesh ankesash |
| ADRESA | `https://piranjat.al/bota/radio-dhe-kitare-elektrike-pa-pushim-policia-arreston-61-vjecarin-pas-7-vit-i105997` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 10:36:29 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 10:23:58 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bd8f7a834e028d4b99c6e41fc880c7823b3729ea3ef6fe21a68692f238efb660` |
| TEKSTI | `0cf42ab30ba8e9bf2011496912799f011911aba16153ecacdc051b5de98e3b2d` |
| PAMJA | `6fe3ff3bd32d651cd488424907f925e4978cca9f4f351a009aa0f6d64259f43f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `998351eed1fc3bca2f34e05daec0eb79af6d18f88f9324ea0f4e6e39c082bbae` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9f67fd8f5341aacd98433415ae2bd1fabd75d8584ec60b7ea3d19ca47caca387` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/998351eed1fc3bca2f34e05daec0eb79af6d18f88f9324ea0f4e6e39c082bbae`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

BOTA

# Radio dhe kitarë elektrike pa pushim, policia arreston 61-vjeçarin pas 7 vitesh ankesash

Piranjat Përditësimi i fundit 25 Shtator 2026, 12:23



Policia japoneze ka arrestuar në Kyoto një 61-vjeçar, i akuzuar se për më shumë se shtatë vjet ka shqetësuar vazhdimisht fqinjët duke lëshuar muzikë me volum shumë të lartë dhe duke luajtur kitarë elektrike në orare të ndryshme të ditës dhe natës, shkruan today.it.

Sipas autoriteteve, Kazunori Yokoi dyshohet se ka shqetësuar të paktën tre banorë të lagjes, të moshës 60 deri në 80 vjeç.

Zhurmat, që sipas hetuesve kanë vazhduar nga qershori i vitit 2019 deri në korrikun e këtij viti, kanë shkaktuar probleme të rënda me gjumin dhe pasoja në gjendjen shëndetësore të banorëve.

Policia ka konstatuar se radioja qëndronte e ndezur gjatë gjithë ditës, ndërsa kitara elektrike luhej nga orët e para të mëngjesit deri në orët e vona të pasdites.

Matjet e kryera nga teknikët kanë regjistruar nivele zhurme prej 80 deri në 90 decibel, të krahasueshme, sipas administratës lokale, me zhurmën brenda një treni në lëvizje.

Një prej banoreve ka zhvilluar tinitus, ose zhurmë/fishkëllimë të vazhdueshme në vesh, ndërsa banorë të tjerë kanë raportuar pagjumësi, depresion dhe probleme të tjera të lidhura me mungesën e pushimit.

Gjatë kontrollit në banesën e 61-vjeçarit, policia sekuestroi 76 pajisje dhe artikuj muzikorë, përfshirë kitara dhe amplifikatorë.

Sipas hetimit, ankesat e para të banorëve datojnë që në janar 2017. Autoritetet e kishin paralajmëruar dhe këshilluar disa herë të dyshuarin për të ndaluar shqetësimet, por situata vazhdoi.

Mes qershorit dhe korrikut të këtij viti, katër banorë vendosën të paraqisnin kallëzime zyrtare, pasi problemet e shkaktuara nga zhurma ishin bërë, sipas tyre, të padurueshme.

Një prej fqinjëve, rreth 60 vjeç, tha se vuante nga një fishkëllimë e vazhdueshme në vesh dhe e përshkroi situatën si një përvojë që e kishte bërë jetesën në banesë të vështirë.

Hetimet ndaj 61-vjeçarit vijojnë për të përcaktuar përgjegjësinë e tij për shqetësimet dhe pasojat e raportuara nga banorët.

## Artikuj te sugjeruar

BOTA 25 Shtator11:44

**SHBA dhe Ekuadori operacion të përbashkët, godasin grupin e një karteli droge meksikan**

Forcat amerikane dhe autoritetet ekuadoriane kanë zhvilluar një operacion të përbashkët kundër një dege lokale të Kart...

BOTA 25 Shtator11:12

**[Alarm në veri të Europës! Forcat suedeze dhe finlandeze zbulojnë avionët ushtarakë rusë mbi Gjirin e Finlandës]**

Forcat ajrore finlandeze thanë të premten se avionë luftarakë suedezë dhe finlandezë ishin ngritur në ajër për t&...

BOTA 25 Shtator10:11

**[“Reuters”: Zonja e Parë e Kinës po afron vendin me amerikanët nëpërmjet “fuqisë së butë”]**

Zonja e Parë e Kinës, Peng Liyuan, ka përdorur diplomacinë kulturore gjatë vizitës së bashkëshortit të saj, presi...

BOTA 25 Shtator09:55

**[Ministri i Jashtëm gjerman viziton Otavën, bisedime mbi sigurinë dhe teknologjinë]**

Ministri i Jashtëm gjerman Johann Wadephul do të vizitojë sot Kanadanë, gjatë një ndalese në Otavë, në kuadë...

Piranjat News BOTA 25 Shtator09:27

**[Mitsotakis: Po dialogut me Turqinë, jo veprimeve të njëanshme]**

Në Nju Jork, Athina hapi të gjitha kartat e saj gjeopolitike brenda pak orësh. Marrëdhënie strategjike me Izraelin , një vij&eum...

BOTA 25 Shtator09:23

**[Presidenti i Serbisë, Vuçiç bën njoftimin e rëndësishëm nga New York-u: Të dielën jap dorëheqjen! Do të bisedoj dhe me Putinin]**

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, ka deklaruar në Nju Jork se do të paraqesë dorëheqjen nga posti i presidentit t...

BOTA 25 Shtator09:15

**[Netanyahu sulmon ashpër kryebashkiakun e New York-ut: Turp të të vijë që shtrembëron faktet]**

Në një grindje të vazhdueshme publike, kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu sulmoi kryetarin e bashkisë së Nju Jorkut, Zohran Mam...

BOTA 25 Shtator09:13

**[“Do t’ua dërgoj familjarëve”/ I mori 15 mijë euro dhe e kërcënoi me fotot nudo, shqiptari përfundon në polici]**

Një 28-vjeçar me origjinë shqiptare është kallëzuar në polici në Rodos nga një 44-vjeçare me origjin&eum...

BOTA 25 Shtator09:12

**[Kolumbia ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Iranin]**

Kolumbia ka njoftuar zyrtarisht ndërprerjen e marrëdhënieve diplomatike me Iranin, duke përmendur shqetësime për sigurinë k...

BOTA 25 Shtator09:10

**[Irani i propozon SHBA-së planin 7-ditor për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit]**

Irani i ka paraqitur Shteteve të Bashkuara një plan shtatëditor për rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, ka deklaruar ministri i J...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 24 Shtator

**[EMRAT/ 63-vjeçari i intubuar te Trauma. Çfarë n...]**

Një ngjarje e rëndë e ndodhur më 16 shtator në Sarandë, e cila nuk ishte bërë publike më herët, ka përfun...

AKTUALITET 24 Shtator

**[Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni...]**

Policia greke ka zhvilluar një aksion në Selanik, ku ka arrestuar tre shtetas shqiptarë të dyshuar për përfshirje në nj&eum...

AKTUALITET 24 Shtator

**[EMRI/ Ra në gropën e ashensorit dhe vdiq, si u ...]**

Altin Kokici, një 51-vjeçar me origjinë shqiptare, është gjetur i vdekur natën mes të mërkurës dhe të enjtes...

Nga Xhuljan Ferzaj INVESTIGIME 23 Shtator11:40

**EKSKLUZIVE/ Eskortat e huaja “mbysin” Tiranën: Si vajzat nga Brazili, Kolumbia e Vietnami ofrojnë shërbime sek*uale për 50-150 euro**

Prostitucioni me shtetase të huaja po shfaqet gjithnjë e më hapur në disa prej qyteteve kryesore të Shqipërisë. Përmes...

## video



## PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 1




“Dua 120 mijë euro”/ Si u zaptua prona në rrugën e Durrësit, zbardhet skema e mashtrimit



**Tmerri i 40-vjeçares / Si u shndërrua njohja e re në përndjekje, shantazh dhe denigrim në rrjet**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.